

Për:	Operatorë Ekonomik: SEYKOS SH.P.K. me adresë në Prishtinë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	24.04.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **Kërkesës për Rishqyrtim**, të datës: **20.04.2023**, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: **SEYKOS SH.P.K. me adresë në Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE**, me Numër të prokurimit: **623-23-3157-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, nxjerr:

VENDIM

- I. **APROVOHET** si pjesërisht e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: **SEYKOS SH.P.K. me adresë në Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE**, me Numër të prokurimit: **623-23-3157-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **04.04.2023**, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>
- II. Duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave, pika II. *Kurdo qe miratimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti Kontraktues do te beje publikimin e Njoftimit për korrigjim te gabimeve, duke përdorur formularin B54*
- III. **Vërejtje:** Komuna do të bëjë korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara sipas Ligjit të Prokurimit Publik **për Pretendimet ankimore qe janë pjesërisht të bazuar.**
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

ARSYETIM

Operatori Ekonomik: **SEYKOS SH.P.K.** me adresë në **Prishtinë**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **NDËRTIMI DHE RREGULLIMI I INFRASTRUKTURËS NË STACIONIN E AUTOBUSËVE**, me Numër të prokurimit: **623-23-3157-5-2-1**, Numër i brendshëm: **623-23-037-5-2-1**, kundër Njoftimit për Kontratë, të datës: **04.04.2023**, të publikuar në ueb – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: **20.04.2023**, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE TË KËRKESËS

Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT):

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2):

Në Vend të:

2.4. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, (duhet te jetë i Certifikuar për Auditor të Sistemit për Menaxhim të cilësisë sipas Standartit Ndërkombëtar ISO 9001-2015);

Ne bazë të Konsultimeve me Ligjin e Prokurimit Publik dhe Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik, kërkesa juaj Aprovohet e bazuar dhe kriteri:

Me formular B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara,

Korrigjohet në:

2.4. Inxhinier i Diplomuar ne Inxhinieri Makinerike ose master - me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit;

Për këtë aktivitet te prokurimit nuk do të zbatohet (do të tërhiqet) Kërkesa e më sipërme e Dosjes se Tenderit - (duhet te jetë i Certifikuar për Auditor të Sistemit për Menaxhim të cilësisë sipas Standartit Ndërkombëtar ISO 9001-2015)

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik ne Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

Astrit Mullabazi

Menaxher i Zyrës se Prokurimit

Komuna e Rahovecit